




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPKI</u>	Nr. Prot. <u>06/2068/20</u>
Dep. <u>DPKI</u>	Prot. No. <u>06/2068/20</u>
Nr. l. faq. <u>02</u>	Data <u>06.10.2020</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>06.10.2020</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>06.10.2020</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 05.10.2020, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. AKK-DPKI- 06-1123/20, për zyrtarin e lartë z. Shemsi Veseli, Drejtor i Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Shemsi Veseli, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli, Drejtor i Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, njëkohësisht mbanë funksion drejtues - kryetar në OJQ-në "Shoqata e Biokimistëve të Kosovës".

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Administratës Publike, verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni dhe nga përgjegjja e pranuar, zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli figuron të jetë kryetar në OJQ-në në fjalë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të LPKI-së, Agjencia kundër Korrupsionit me shkresën zyrtare DPKI-06-1288/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerret për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarit i lartë publik nuk mundet që, njëkohësisht me ushtrimin e funksionit publik, të mbajë funksion drejtues në OJQ, sepse kjo situatë është në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 1, të LPKI-së, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit, gjegjësisht ka pranuar se është kryetar i OJQ-së “Shoqata e Biokimistëve të Kosovës”, por ka deklaruar se asnjë herë nuk ka përfituar financiarisht nga kjo OJQ. I njëjti ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime konkrete në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar njoftimin nga Departamenti për OJQ i Ministrisë së Administratës Publike (DPKI-06-1992/20), me të cilin konfirmohet se zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli ka dhënë dorëheqje nga funksioni drejtues në OJQ-në “Shoqata e Biokimistëve të Kosovës”, si dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Kryetar në OJQ-në në fjalë.

Pas analizimit të njoftimit për ndryshimet në OJQ, Agjencia kundër Korrupsionit konstatoi se me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.3, të LPKI-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

